

VENDIM
Nr. 43, datë 30.4.2013

**MBI NDRYSHIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE TË CERTIFIKIMIT TË
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA BURIMET E ENERGJISË SË
RINOVUESHME**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa “m” iv, nenit 9 dhe të nenit 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.4.2013, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

VENDOSI:

- Në rregullat dhe procedurat e certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, miratuar me vendim të Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, bëhet një ndryshim dhe një shtesë në paragrafin e dytë, neni 7 të tij:

“Kërkesa për kualifikim mund të paraqitet për një central prodhues, të vënë në operim për herë të parë paralel me rrjetin elektrik pas 2.11.2000.

Mund të kualifikohen si burime të rinovueshme energjie dhe hecet me fuqi të instaluar nën 10 MW, të vëna në punë jo më pak se 15 vjet më parë dhe që janë objekt i fuqizimit dhe i ripunimit total pasi të verifikohen në vend këto punime.

Mund të kualifikohen si burime të rinovueshme energjie dhe hecet me fuqi të instaluar të barabartë, apo mbi 10 MW, të vëna në punë jo më pak se 30 vjet më parë dhe që janë objekt i fuqizimit dhe i ripunimit total pasi të verifikohen në vend këto punime.

Kërkesa për kualifikim mund të paraqitet, gjithashtu, për një central prodhues energjie të rinovueshme dhe në fazën e projektimit ose në fazën e ndërtimit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani